
	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Operatorë Ekonomik: MEB L.L.C. me adresë në Prizren Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	14.03.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **13.03.2024**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **MEB L.L.C.** me adresë në **Prizren**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **SIGURIMI FIZIK I OBJEKTEVE TË KOMUNËS**, me Numër të prokurimit: **623-24-1213-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-021-2-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **HEDHET SI E PALEJUAR** kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **MEB L.L.C.** me adresë në **Prizren**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **SIGURIMI FIZIK I OBJEKTEVE TË KOMUNËS**, me Numër të prokurimit: **623-24-1213-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-021-2-2-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **20.02.2024**, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: **SIGURIMI FIZIK I OBJEKTEVE TË KOMUNËS**, me Numër të prokurimit: **623-24-1213-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-021-2-2-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

A R S Y E T I M

Operatori Ekonomik: **MEB L.L.C.** me adresë në **Prizren**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **SIGURIMI FIZIK I OBJEKTEVE TË KOMUNËS**, me Numër të prokurimit: **623-24-1213-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-021-2-2-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **20.02.2024**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **13.03.2024**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

Operatori Ekonomik: **MEB L.L.C.** me adresë në **Prizren**, me datën: **13.03.2024** si palë e pa kënaqur ndaj Njoftimit për kontratë të Autoritetit Kontraktues të datës: **20.02.2024** ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim për aktivitetin e prokurimit: **SIGURIMI FIZIK I OBJEKTEVE TË KOMUNËS**, me Numër të prokurimit: **623-24-1213-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-24-021-2-2-1**, duke supozuar se janë shkelur dispozitat e Nenit 27, 51 dhe 69 të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues, brenda afatit ligjor ka shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës ku ka konstatuar si vijon:

Bazuar në legjislacionin primar dhe atë sekondar të prokurimit publik pretendimet tuaja ankimore nuk kanë asnjë bazë ligjore, të gjitha kërkesat tona janë në raport me lëndën dhe qëllimin e kontratës dhe se të njëjtat janë më se ligjore, të gjitha kërkesat e vendosura ndërliidhen me veprimtarinë dhe natyrën e sigurisë fizike.

- Ju nuk keni arritur të dëshmoni se jeni palë me interes konform **Nenit 4.1.26 të LPP-së**, dhe **Nenit 60.3 pika e)** e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik pasi që sipas vendimit të OSHP-së me **nr.1118/23** e dt.**19.12.2023** ju jeni operator ekonomik ***diskualifikuar dhe i listuar në listën e zezë*** të OSHP-së e që fakti ju bënë të pamundur të ofertoni në aktivitete të prokurimit deri më **datë 18.03.2024**.
- Ju sipas vendimit të OSHP-së keni rënë në kundërshtim me **Nenin 65 par.4.11 e LPP-së** ku thuhet se “*...ka dhënë deklarata të rreme në lidhje me procedurën për dhënien e një kontrate publike, nëse këto kanë të bëjnë me mungesën e arsyeve për përjashtim, ose me përmbushjen e kritereve të përzgjedhjes...*”, një gjë të till shihet sipas vendimit të lartcekur se ju keni dhënë deklarata të rreme tek AQP, për të cilën OSHP ka aprovuar kërkesën e AK-së për të ju listuar në listën e zezë.
- **Neni 67.9** i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik cek se: ***Në rast se OSHP nxjerr një vendim për diskualifikim të një operatori ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik, atëherë OE i diskualifikuar nuk ka të drejtë të merr pjesë në asnjë aktivitet të prokurimit prej datës së vendimit.***

Andaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga ana juaj **është e pabazuar**.

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>